



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1120/Prot
1

Tiranë, më 29/9 /2020

VENDIM

Nr. 40 , datë 29. 9 .2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, Shoqata “Together for Life”, përfaqësuar nga znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1120 Prot., datë 21.09.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Spitali Rajonal Durrës” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet shkresës datë 02.09.2020, ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion dokumentacioni/informacioni si më poshtë:

1. Sa është buxheti i vënë në dispozicion për Spitalin Rajonal Durrës, për përballimin e situatës së COVID-19?
2. A ka bërë Spitali Rajonal Durrës, kërkesë për fonde në kuadër të përballimit të situatës së krijuar nga COVID-19? Nëse po, sa është fondi i kërkuar?
3. Si ka ndikuar situata e krijuar nga COVID-19, në të ardhurat dytësore të spitalit? A ka patur ulje të të ardhurave dytësore?
4. Si është bërë riorganizimi i fondeve të spitalit pas situatës së krijuar nga COVID-19?
5. Cila ka qenë procedura e tenderit për përballimin e situatës së COVID-19?
6. A ka patur tendera të planifikuara në fillim të vitit buxhetor të cilët janë kryer edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme? Sa kanë qenë dhe cili ka qenë objektivi i tyre?

7. *Sa ka qenë numri i tenderave të realizuar për përballimin e situatës së COVID-19, në Spitalin Rajonal Durrës?*
8. *Sa ka qenë buxheti për blerjen e materialeve mjekësore të nevojshme për mbrojtjen e personelit mjekësor gjatë periudhës së COVID-19 (deri në 1 shtator 2020)?*
9. *Sa ka qenë buxheti për blerjen e pajisjeve dhe medikamenteve të nevojshme shëndetësore për ofrimin e shërbimit për pacientët e prekur me COVID-19 (deri me 1 shtator 2020)?*
10. *A është kryer desinfectimi i Spitalit Rajonal Durrës? Sa ka qenë buxheti i vënë në dispozicion?*
11. *A është aplikuar procedurë e veçantë tenderimi për blerjet e dedikuara për COVID-19 dhe ku është bazuar procedura?*
12. *A ka qenë i mjaftueshëm buxheti i vënë në dispozicion për përballimin e nevojave të krijuara nga COVID-19?*
13. *A ka patur donacione në Spitalin Rajonal Durrës, në kuadër të përballimit të situatës së krijuar nga COVID-19? Nëse po, cilët janë donatorët? Konkretisht, çfarë donacionesh janë kryer?*

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 1580/1 Prot., datë 04.09.2020 ka kthyer përgjigje, duke informuar kërkuesen ndër të tjerat se: *"...Buxheti i akorduar për Spitalin Rajonal Durrës për përballimin e situatës Covid-19 është i mjaftueshëm për përballimin e nevojave. Aktualisht, nevojat për përballimin e situatës janë përballuar nëpërmjet furnizimeve nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për materiale dhe mjete mbrojtëse, aparatura mjekësore bashkëkohore, buxheteve shtesë të akorduara për zërin 600 - Paga dhe Sigurime dhe zërin 602 – Mallra e Shërbime të tjera, si edhe nëpërmjet donacioneve të bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve private të ndryshme. Pavarësisht situatës Covid – 19, Spitali Rajonal Durrës ka punuar me kapacitete të plota burimesh njerëzore, si për anën mjekësore ashtu edhe për atë administrative. Spitali Rajonal Durrës ka marrë vazhdimisht të gjitha masat e nevojshme sipas protokollit për desinfectimin e ambienteve të jashtme, të brendshme dhe autoambulancave të spitalit."*

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, ankuesja, me pretendimin se, informacioni i dhënë nuk ezauron të gjitha pikat e kërkesës për informacion të datës 02.09.2020, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit, megjithëse mirëkupton vështirësitë e hasura për shkak të problematikave të krijuara nga COVID – 19, nuk përjashton në asnjë moment Autoritetin Publik nga detyrimi për të ushtruar veprimtarinë e tij në lidhje me transparencën.

Për rrjedhojë, pas shqyrtimit të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, Komisioneri, vlerëson se, ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara

në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ankuesja legjitimohet në kërkimin e saj.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, Komisioneri konstaton se, Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 1580/1 Prot., datë 04.09.2020, ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion, konkretisht, për pikën 12. *A ka qenë i mjaftueshëm buxheti i vënë në dispozicion për përballimin e nevojave të krijuara nga COVID-19 si dhe pjesërisht për pikat 10. A është kryer desinfektimi i Spitalit Rajonal Durrës dhe 13. A ka patur donacione në Spitalin Rajonal Durrës, në kuadër të përballimit të situatës së krijuar nga COVID-19? Nëse po, cilët janë donatorët.* Përsa më sipër, vlerësohet se, Autoriteti Publik ka përmbushur detyrimin për dhënie informacioni në lidhje me këto pika.

Në lidhje me pikat e tjera të kërkesës Autoriteti Publik nuk ka argumentuar mosdhënien e informacionit.

Në pikat 2 dhe 3 të nenit 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, parashikohet se:

2. *“Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuesin.*

3. *Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar. Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuesin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.”*

Sa më sipër, parashikohet gjithashtu dhe në shkronjën “d”, të pikës 2, neni 10 i ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” sipas të cilit “koordinatori për të drejtën e informimit dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.

Bazuar në këto parashikime, nuk rezulton që Autoriteti Publik të ketë deleguar kërkesën për informim tek autoriteti kompetent përkatës dhe as të ketë dhënë argumenta lidhur me mosvënien në dispozicion të të gjithë dokumentacionit/informacionit të listuar në shkresën e datës 02.09.2020.

Nga shqyrtimi i kërkesës për informacion, rezulton se, informacioni përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të

kërkuesit çdo informacion/dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e disponuar.

Autoriteti Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ku përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, *“autoriteti publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj”*. Ndërkohë në pikën 1, të nenit 18 parashikohet se *mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të tij. Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë.*

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Shoqatës “Together for Life” ndaj Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1120 Prot., datë 21.09.2020 të Shoqatës “Together for Life”, kundër Autoritetit Publik “Spitali Rajonal Durrës”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit/informacionit të kërkuar në lidhje me:

1. Sa është buxheti i vënë në dispozicion për Spitalin Rajonal Durrës, për përballimin e situatës së COVID-19?
2. A ka bërë Spitali Rajonal Durrës, kërkesë për fonde në kuadër të përballimit të situatës së krijuar nga COVID-19? Nëse po, sa është fondi i kërkuar?
3. Si ka ndikuar situata e krijuar nga COVID-19, në të ardhurat dytësore të spitalit? A ka patur ulje të të ardhurave dytësore?
4. Si është bërë riorganizimi i fondeve të spitalit pas situatës së krijuar nga COVID-19?
5. Cila ka qenë procedura e tenderit për përballimin e situatës së COVID-19?
6. A ka patur tendera të planifikuar në fillim të vitit buxhetor të cilët janë kryer edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme? Sa kanë qenë dhe cili ka qenë objektivi i tyre?
7. Sa ka qenë numri i tenderave të realizuar për përballimin e situatës së COVID-19, në Spitalin Rajonal Durrës?
8. Sa ka qenë buxheti për blerjen e materialeve mjekësore të nevojshme për mbrojtjen e personelit mjekësor gjatë periudhës së COVID-19 (deri në 1 shtator 2020)?
9. Sa ka qenë buxheti për blerjen e pajisjeve dhe medikamenteve të nevojshme shëndetësore për ofrimin e shërbimit për pacientët e prekur me COVID-19 (deri me 1 shtator 2020)?
10. Sa ka qenë buxheti i vënë në dispozicion?
11. A është aplikuar procedurë e veçantë tenderimi për blerjet e dedikuara për COVID-19 dhe ku është bazuar procedura?
13. Konkretisht, çfarë donacionesh janë kryer, brenda datës 06 . 10 .2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 29 . 9 .2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

